

Angazhohu Monitoro Vepru



SUPLEMENT NGA GRUPI MONITORUES I KËSHILLIT BASHKIAK, POGRADEC, TETOR 2012

“Për më shumë se një minutazh, karton, diskutim...

Nise këtë radhë me një përshtypje, mendim!

Qytetar, eja monitoro dhe Ti!”

Monitorimi
i Këshillit
Bashkiak,
Pogradec
Dosja Nr. 6,
Tetor 2012



**NJË MBLEDHJE RUTINË E
KËSHILLIT BASHKIAK**.....faqe 6

TRAMPOLINA E VULLNETARIZMIT.....faqe 6

**INTERVISTA:
1 VIT KËSHILLI BASHKIAK**.....faqe 7

**KORÇA PROMOVON
PJESËMARRJEN AKTIVE**.....faqe 10

**ZGJIDHNI QUITZ NË FAQEN 11 DHE MERRNI NJË DHURATË NGA
GRUPI MONITORUES**

EDITORIAL

Fillesat e angazhimit tim në projektin “ANGAZHOHU – MONITORO - VEPRO” kanë qenë me pikësynimin për t’u trajnuar dhe pajisur më pas me një certifikatë mbi “Monitorimin e Këshillit Bashkiak”, dokument i cili do t’i shtohet CV-së sime të punës, duke më aftësuar dhe zgjeruar diapazonin e njohurive mbi një rënë prej lëndëve të cilat asistoj në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, si: ‘Vetëqeverisja Lokale dhe Pushteti Vendor’.

Por dobishmëria e këtij angazhimi rezultoi me detyra dhe përgjegjësi të reja. Duke patur një eksperiencë modeste në botime të karakterit shkencor dhe pas dhënies së përshtypjeve të para mbi monitorimin e Këshillit Bashkiak, u përzgjodha nga grupi monitorues dhe moderatorët e programit si kryeredaktor i një botimi, që do të trajtonte pikërisht çështje të

karakterit analitik dhe sugjerues për monitorimin e mbledhjeve nga ana jonë.

Edicionet e Buletinit “ANGAZHOHU – MONITORO - VEPRO” u pasuan me shkrime të ndryshme nga pjestarë të grupit monitorues. Opinionet mbi shkrimet dhe publikimet tona, më ndërgjegjësuam për një rritje të përgjegjësisë dhe detyrës qytetare, ku natyrisht bëja pjesë edhe unë, duke tejkaluar tashmë interesin fillestar në trajtën e integritetit të një trupe qytetarësh me interes më të gjerë dhe kontributdhënës për komunitetin.

Edhe pse jam i angazhuar gjatë javës jashtë shtetit, kjo nuk do të bëhet pengesë që njëherë në muaj të kthehem për të qenë, si muajt e kaluar, një monitorues i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe të vazhdoj pandërprerje

koordinimin e botimit të buletinit tonë.

Do të dëshiroja jetëgjatësinë e këtij projekti, jo vetëm për të qenë promotor i angazhimit të disa të rinjve, të cilët janë në udhën e drejtë të perfeksionimit të tyre në këtë sferë, por edhe për të mos stepur qytetarët e interesuar për të mbikqyrur dhe ndikuar në vendimmarrjen lokale pro interesave dhe dobisë qytetare.

Kryeredaktori

Kryeredaktor: DORIAN LEKA

Redaktor letrar: ILIR SHYTA

Design&Layout: ALBAN GUSHO

OPINION

NJË Mbledhje rutinë e Këshillit Bashkiak

Dhimitër Gegprifti

Si edhe herë të tjera, axhenda e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të Pogradecit e datës 27.09.2012 ishte e rënduar. E themi këtë për faktin se mbledhjet në të shumtën e rasteve janë të ngarkuara me shumë çështje, që jo rrallë arrijnë edhe në 10-12. Por një gjë e tillë vihet re edhe kur Këshilli midis tyre ka çështje themelore, siç është ajo e Buxhetit, për të cilën interesi publik është më i ndjeshëm. Çështja e Buxhetit për Bashkinë e Pogradecit, në këto dy vitet e fundit, ka qenë në qendër të vëmendjes për mungesë fondesh, të cilat sikur kanë ngadalësuar investimet publike.

Ndër tetë çështjet, që do të diskutonte kjo mbledhje ishte dhe “Analiza financiare e 6-mujorit të parë të Bashkisë”. e cila si zakonisht lihet e parafundit, që nuk është e tillë nga rëndësia. U diskutuan dhe u miratuan 6 projektvendime, dy nga të cilët “Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-31 gusht 2012 dhe 1-30 shtator 2012, “Për largimin nga lista e të pastrehëve të familjeve, që kanë fituar kredi me kushte lehtësuese”, “Për miratimin e rregullores mbi mënyrën e shqyrtimit të kërkesave për kryerjen e punimeve, si dhe për

miratimin e hartave të përdorimit të tokës dhe të nën/njësive strukturore”, “Për përfaqësuesin e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Asamblenë e aksionerëve të UK-sh.a dhe të drejtat e përfaqësimit”, si dhe “Mbi rishqyrtimin e tarifës të ujit të pijshëm dhe të ujrave të përdorura (të zeza)”.

Si zakonisht, pyetjet dhe diskutimet të pakta, të lenë të kuptosh se këshilltarët duan t’i kalojnë shpejt. Duket se nuk thellohen në materialin e shpërndarë. Jo të gjitha komisionet mblidhen, por edhe kur mblidhen, nuk sjellin argumenta bindëse pro ose kundër për projektvendimet në tërësi, por edhe për elementë të tij. Mjaftohen me shprehjet: komisini u mblodh, e pa dhe është i mendimit ta miratojmë”, ka dhe këshilltarë, që raportojnë të kundërtën, por nuk thonë “pse”-të. Dukuri të tilla pati edhe në këtë mbledhje. Ajo që hapi disi pyetje dhe diskutime ishte shqyrtimi i tarifës së ujit dhe ujrave të përdorura: tarifat e ujit të pijshëm në lek/m³ për familje 60, për institucionet buxhetore dhe private 110. Tarifa e kanalizimeve për familje 33, institucionet buxhetore dhe private 36, tarifë shërbimi 100.

Diskutimi për këtë pikë u përqëndruan në një grup, që ishin kundër rritjes, duke e parë atë në aspektin social, në pamundësinë e komunitetit dhe ndër ata, ku bënte pjesë dhe titullari zoti Artan Shkëmbi për ta miratuar ne si këshill, pasi vulën përfundimtare do t’ia japi enti rregullator. Mos miratimi nga ana jonë, argumentoi ai, do të çënojë marrëdhëniet e mira që kemi deri tani me KFV dhe investimet e tjera, që ka ajo në këtë qytet. Kjo çoi përfundimisht në miratimin e tarifave të reja.

Shumë pak kohë iu kushtua analizës financiare. Diskutime të vetmuara. Të krijohet ideja sikur palët duan të mos prishin “ekuibrat politikë”. Harrojnë se tashmë janë këshilltarë dhe për zhvillimin e qytetit, për kushtet më të mira të komunitetit jemi të interesuar të gjithë. Miratohen me ngritje kartonësh faqe të tëra me shifra, pa kërkuar Ku?, Pse?, Si?, Ç’do të bëhet në të ardhmen? Objektet e investimit, përfundimi ose jo, arsyet, likujdimi. Është analizë financiare dhe kërkon vërtet analizë e diskutime konkrete, që në të shumtën e rasteve, sa është cekur dhe pothuajse ka munguar dhe vazhdon të mungojë. Nuk e dimë pse?

OPINION

TRAMPOLINA E VULLNETARIZMIT

Nga Doralda Tanellari

Puna vullnetare ka qenë një çështje shumë e debatuar që para vitit 1990 dhe deri në ditët tona. Po çfarë është vullnetarizmi dhe si konceptohet ai nga brezat? Nëse pyet prindërit tanë për vullnetarizmin do të shprehen në këtë mënyrë: –“Puna vullnetare ishte punë komuniste, pa shpërblim, që e kryenin vullnetarisht masat punonjëse dhe rinia në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Pra, koncepti i vullnetarizmit përkthehej fare mirë në punë pa pagesë, por me detyrim, i tillë ka qenë përcaktimi i punës vullnetare edhe në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar”.

Në këtë mënyrë, kur ju kujton vullnetarizmin shqiptarëve ata mendojnë për orët e gjata të punës dhe pa shpërblim, mundin që duhet të kalonin vetëm e vetëm të bënin orët shtesë të caktuara nga qeveria e asaj kohe. Si të thuash, ishte një ndjenjë frike shoqëruar me ndjenjën e revoltës që ju përçon ajo kohë edhe për faktin se ata nuk mund ta kishin as forcën

dhe përkrahjen për të ngritur zërin apo vepruar ndryshe. Kjo është arsyeja që nëse i pyet se çfarë mendojnë për vullnetarizmin ata flasin me rezerva, sepse sot ata nuk e kanë të njohur tërësisht konceptin e vullnetarizmit të një bote moderne dhe të demokratizuar. Megjithatë, media ka dhënë dhe jep një impakt të



rëndësishëm për njerëzit duke i njohur ata me veprimtarinë dhe punën vullnetare të shumë organizatave dhe të ndërmarjeve të pavarura vullnetare të shoqërisë civile.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Europën Perëndimore fëmijët edukohen që në shkolla rreth konceptit të vullnetarizmit dhe

mënyrën sesi ata duhet të veprojnë me ata njerëz që kanë nevoja ekonomike apo edhe shanse të pabarabarta në jetë. Sot në botë ka shumë pabarazi sociale, ndjenja e materializmit ka përfshirë të gjithë brezat sidomos të rinjtë e kohëve të sotme. Jetojnë në një botë ku mundësitë e barabarta bien ndesh me shanset e pabarabarta, ku të pasurit bëhen më të pasur dhe të varfërit më të varfër. Kjo është arsyeja pse duhet të nxitet ndjenja e punës vullnetare sepse ajo rrit dhe ndihmon të rinjtë të edukohen me frymën e bashkëpunimit me ata që kanë nevojë dhe ju fal kënaqësi fakti, që bashkëmohatarët e tyre mund edhe të “jetojnë” edhe falë punës të tyre të papaguar, por që shpërblimi është i dukshëm... Një jetesë e qetë dhe me eksperiencë pozitive jetësore. Shpeshherë janë të rinjtë që organizohen në grupe pune, me edukatën e marrë në shkolla dhe në familje, por më e rëndësishmja, me dëshirën për të ndihmuar të tjerët.

vijon në faqen 12

INTERVISTA

1 vit Këshilli Bashkiak

Nga Leonida Karaj

INTERVISTË ME
Z.NJ. MIMOZA SHULIINTERVISTË ME
Z.SYRJA PALLA

1- Çfarë përshtypjesh keni për punën 1-vjeçare të Këshillit Bashkiak?

Së pari, dua të theksoj se Këshilli Bashkiak aktual është i ri, i formuar këtë vit, por qenia e pranishme e disa këshilltarëve të vjetër bëri që të mos ndihej mungesa e përvojës dhe unë e vlerësoj të mirë ecurinë dhe efektivitetin e punës së këshillit. Në ndonjë rast të mosfunksionimit të një komisioni, unë e shpjegoj me faktin që kanë qenë çështje të mirënjohura nga ana e këshillit dhe nuk është ndjerë e nevojshme veprimi i këtij organi në fushën përkatëse.

2- Cili ka qenë diskutimi më i debatuar gjatë mbledhjeve tuaja dhe si e zgjidhët atë?

Mendoj se çështja më e rëndësishme që është diskutuar përgjatë mbledhjeve të KB është çështja e zëvendësimit të Bordit Drejtues së UK-së. Iu nënshtrua diskutimeve të forta nga të dyja palët. Njëra palë e drejtuar politikisht, e cila nuk donte rinovimin e bordit drejtues, ku një pjesë e tyre u largua pjesërisht nga ai takim (mbledhje). Bordi u ndërrua me shumicë dhe koha tregoi se veprimi i ndërrimit të bordit ishte i drejtë. Kjo duket në marrëdhëniet që ka administrata e ndërmarrjes dhe bordit ku nuk ka më diskutime. Shpresojmë që kjo të ndikojë sa më pozitivisht në ndërmarrjen UK.

3- E njihni botimin tonë “Angazhohu – Vepro - Monitoro”, nëse jo, pse? Nëse po, cili është opinion tuaj mbi angazhimin tonë, ndonjë sugjerim i mundshëm?

Edhe pse s’kam lexuar ndonjë material të mirëfilltë, kam përshtypjen se bordi juaj është aktiv, gjë të cilën e vë re në pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve, të cilët e ndjekin aktivitetin e këshillit nga fillimi deri në fund. Gjithashtu, më bën përshtypje kontakti individual që bëni me përfaqësues të veçantë të këshillit në interes të mirëinformimit.

1- Çfarë përshtypjesh keni për punën 1-vjeçare të Këshillit Bashkiak?

Duke parë krizën financiare që ka përfshirë të gjitha rrethet, ashtu dhe Pogradecin, mendoj që 6-mujorin e parë, puna e Këshillit Bashkiak është për t’u lavdëruar. Gjërat kanë ecur shumë mirë, pasi objektivat janë realizuar në mënyrë efektive. Por ajo ç’ka me shqetëson edhe si këshilltarë edhe si biznesmëne, lidhet me regjistrimin e bizneseve të vogla të palicensuara.



Në qoftë se do realizohet një punë e mirë e tatim-taksave, të mblidhet një pjesë e konsiderueshme e taksave, atëherë do kemi dhe një rritje të të ardhurave të buxhetit të Këshillit Bashkiak.

2- Cili ka qenë diskutimi më i debatuar gjatë mbledhjeve tuaja dhe si e zgjidhët atë?

Përderisa është trajtuar rreth 3 seanca rresht, mendoj se çështja më e debatuar “UK-Pogradec” ka qenë pika më e nxehtë e diskutimeve. Unë personalisht nuk kam qenë dakort për rritjen e tarifës së ujit, megjithatë kjo tarifë ishte shumë e vogël, sepse rritej vetëm 0.5 lek, ajo është shumë e ndjeshme tek qytetarët. Ndaj duhet marrë në konsideratë kriza financiare dhe pamundësia e pagesës nga ana e qytetarëve. Arsyeja kryesore për të cilën unë nuk jam dakort është një çështje tjetër, të cilës i duhet kushtuar shumë rëndësi, përkatësisht përfundimi i veprës madhore të

rrjetit të kanalizimeve. Duhet t’i shohim të dyja problemet: 1) Rritja e tarifës së ujit 2) Mosfunksionimi i projektit të kanalizimeve.

Sigurisht, që këtij të fundit duhet t’i japim rëndësi dhe zgjidhje. Pasi qyteti i Pogradecit rezulton si një qytet potencial turistik dhe burimin kryesor të të ardhurave e siguron nga Turizmi, ndaj që t’i japim nje hov të mëtejshëm të zhvillimit të turizmit duhet të përfundojë mepatjetër sistemi i rrjetit të kanalizimeve (sidomos pjesa që përfshin Lumin e Vërdovës, ku janë fokusuar shumë biznese hotelore dhe turistike). Nëse do të përfundojë kjo veper madhore për qytetin tone, shpresoj të ketë

rritje të turizmit, rritje të numrit të turistëve dhe sigurisht, rritje të të ardhurave tek qytetarët. Ndaj, mendoj se është më e rëndësishme kjo çështje sesa rritja e kuotës së çmimit të ujit tek qytetarët.

3- E njihni botimin tonë “Angazhohu – Vepro - Monitoro”, nëse jo, pse? Nëse po, cili është opinion tuaj mbi angazhimin tonë, ndonjë sugjerim i mundshëm?

Më vjen mirë që një grup të rinjsh si ju kanë ndërmarrë një nismë të tillë dhe që i shikojnë ngjarjet, debatet apo diskutimet e Këshillit Bashkiak pa ngjyrimë politike. Madje, në prezencën tuaj edhe gjithë puna e Këshillit Bashkiak bëhet më transparente. Unë ju falenderoj për angazhimin, punën që bëni me kaq vullnet dhe dëshirë, edhe pse jo, të mos jeni ju ulur nesër në ato karrige dhe t’i realizoni gjërat më suksesshëm se ne, sepse unë mendoj se eksperiencia që po merrni nga monitorimi i KB do iu vlejë shumë në të ardhmen.

A E DINI SE:

Në vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 2, datë 02.02.2001, janë bërë ndryshimet e mëposhtme:

Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 24

ISHTE:
Ndalohet qëndrimi i mjeteve në venqëndrimet e aprovuara pa lejën e veprimtarisë përkatëse.

BËHET:
Ndalohet qëndrimi i mjeteve në venqëndrimet e aprovuara pa lejën e veprimtarisë përkatëse.



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 25

ISHTE:
Ndalohet qëndrimi i autobuzëve në vendqëndrimet e miratuara me tepër se ___orë para nisjes dhe ___ orë pas nisjes, sipas kontratës së lidhur me Bashkinë dhe Ministrinë.

BËHET:
Ndalohet qëndrimi i autobuzëve në vendqëndrimet e miratuara me tepër se ___orë para nisjes dhe ___ orë pas nisjes, sipas kontratës së lidhur me Bashkinë dhe Ministrinë.



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 26

ISHTE:
Ndalohet prishja e radhës së taksive në venqëndrim, lëvizja brenda venqëndrimeve dhe thirrjet për vendgrumbullim udhëtarësh.

BËHET:
Ndalohet prishja e radhës së taksive në venqëndrim, lëvizja brenda venqëndrimeve dhe thirrjet për vendgrumbullim udhëtarësh.



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 27

ISHTE:
Ndalohet lëvizja e mjeteve në qytet jashtë skemës së përcaktuar, e plotësuar me sinjalizim nga Bashkia.

BËHET:
Ndalohet lëvizja e mjeteve në qytet jashtë skemës së përcaktuar, e plotësuar me sinjalizim nga Bashkia.



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 28

ISHTE:
Ndalohet qarkullimi i mjeteve të tonazhit mbi 2 ton në të gjitha rrugët e qytetit, përveç Unazës pa autorizim nga Bashkia).

BËHET:
Ndalohet qarkullimi i mjeteve të tonazhit mbi 2 ton në të gjitha rrugët e qytetit, përveç Unazës pa autorizim nga Bashkia).



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 29

ISHTE:
Ndalohet qarkullimi me shpejtësi mbi 40 km në orë në të gjitha rrugët e qytetit.

BËHET:
Ndalohet qarkullimi me shpejtësi mbi 40 km në orë në të gjitha rrugët e qytetit.



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 30

ISHTE:
Ndalohet rënia e borive të makinave nga ora 18.00-08.00.

BËHET:
Ndalohet rënia e borive të makinave nga ora 18.00-08.00.



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 31

ISHTE:
Ndalohet qarkullimi e parkimi i mjetit të mallit në tregje gjatë ditës prej orës 08.00-17.00 në stinën e dimrit dhe prej orës 07.00-18.00 në stinën e verës.

BËHET:
Ndalohet qarkullimi e parkimi i mjetit të mallit në tregje gjatë ditës prej orës 08.00-17.00 në stinën e dimrit dhe prej orës 07.00-18.00 në stinën e verës.



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 32

ISHTE:
Ndalohet parkimi i mjeteve për shitje produktesh nga makina në rrugë dhe sheshe tregu, të pamiratuara nga Bashkia.

BËHET:
Ndalohet parkimi i mjeteve për shitje produktesh nga makina në rrugë dhe sheshe tregu, të pamiratuara nga Bashkia.



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 33

ISHTE:
Ndalohet qarkullimi i makinave, motoçikletave dhe motokarrove në shëtitoret e caktuara nga Bashkia jashtë orareve të përcaktuara.

BËHET:
Ndalohet qarkullimi i makinave, motoçikletave dhe motokarrove në shëtitoret e caktuara nga Bashkia jashtë orareve të përcaktuara.



Në pikën e II-të, “Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor”, neni 34

ISHTE:
Ndalohet qarkullimi dhe parkimi në trotuare, lulishte, parqe, hyrje dhe rrugëkalim midis pallateve dhe në blloqe banimi i mjeteve të transportit jashtë pikave të caktuara.

BËHET:
Ndalohet qarkullimi dhe parkimi në trotuare, lulishte, parqe, hyrje dhe rrugëkalim midis pallateve dhe në blloqe banimi i mjeteve të transportit jashtë pikave të caktuara.



INFORMOHUNI

Në pikën e II-të, "Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor", Neni 35

ISHTE:

Ndalohet qarkullimi i mjeteve që kanë rrjedhje vaji dhe valvoline, si dhe rrjedhje materiali jashtë karrocierie.

BËHET:

Ndalohet qarkullimi i mjeteve që kanë rrjedhje vaji dhe valvoline, si dhe rrjedhje materiali jashtë karrocierie.

Gjoha: 2000 lek

Gjoha: 5000 lek

Në pikën e II-të, "Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor", neni 36

ISHTE:

Ndalohet qarkullimi i karrocave jashtë drejtimeve të aprovuara dhe të pa pajisura me qese për kafshët.

BËHET:

Ndalohet qarkullimi i karrocave jashtë drejtimeve të aprovuara dhe të pa pajisura me qese për kafshët.

Gjoha:
500-1000 lek

Gjoha: 1000 lek

Në pikën e II-të, "Për ruajtjen e rregullit dhe qarkullimit rrugor", neni 37

ISHTE:

Ndalohet larja dhe riparimi i mjeteve në ambjente publike si shëtitore, rrugë, parqe, sheshe dhe blloqe banimi.

BËHET:

Ndalohet larja dhe riparimi i mjeteve në ambjente publike si shëtitore, rrugë, parqe, sheshe dhe blloqe banimi.

Gjoha: 1000 lek

Gjoha: 2000 lek

Në pikën e III-të, "Veprimet në Liqen", neni 42

ISHTE:

Ndalohet larja e automjeteve për gjatë gjithë bregut të liqenit.

BËHET:

Ndalohet larja e automjeteve për gjatë gjithë bregut të liqenit.

Gjoha: 1000 lek

Gjoha: 5000 lek

Në pikën e III-të, "Veprimet në Liqen", neni 43

ISHTE:

Ndalohet hyrja e varkave të paregjistruara e të pakolauduara nga Komisarjati i Korçës. (Policia kufitare)

BËHET:

Ndalohet hyrja e varkave të paregjistruara e të pakolauduara nga Komisarjati i Korçës. (Policia kufitare)

Gjoha: 3000 lek

Gjoha: 5000 lek

Në pikën e III-të, "Veprimet në Liqen", neni 44

ISHTE:

Ndalohet hyrja e varkave për shëtitje me pasagjerë nga ora 20.00-04.00 dhe të çdo varke në mot të papërshtatshëm gjatë gjithë periudhës vjetore.

BËHET:

Ndalohet hyrja e varkave për shëtitje me pasagjerë nga ora 20.00-04.00 dhe të çdo varke në mot të papërshtatshëm gjatë gjithë periudhës vjetore.

Gjoha: 1000 lek

Gjoha: 2000 lek

Në pikën e III-të, "Veprimet në Liqen", neni 45

ISHTE:

Ndalohet vozitja e varkave për pasagjerë mbi kapacitetin e lejuar në certifikatën teknike. Për varkat e zakonshme pa motor, jo më shumë se 5 persona dhe detyrimisht me drejtuesin e varkës të aftë për të marrë masa në rast rreziku dhe me mjetet e sigurimit për jetën.

BËHET:

Ndalohet vozitja e varkave për pasagjerë mbi kapacitetin e lejuar në certifikatën teknike. Për varkat e zakonshme pa motor, jo më shumë se 5 persona dhe detyrimisht me drejtuesin e varkës të aftë për të marrë masa në rast rreziku dhe me mjetet e sigurimit për jetën.

Gjoha: 4000lek

Gjoha: 5000 lek

Në pikën e III-të, "Veprimet në Liqen", neni 46

ISHTE:

Ndalohet peshkimi nga peshkatarë profesionistë e sportivë pa u pajisur me dokumentacionin përkatës për këtë veprimtari.

BËHET:

Ndalohet peshkimi nga peshkatarë profesionistë e sportivë pa u pajisur me dokumentacionin përkatës për këtë veprimtari.

Gjoha: 1000 lek

Gjoha: 2000 lek

Në pikën e III-të, "Veprimet në Liqen", neni 47

ISHTE:

Ndalohet parkimi i varkave jashtë vendeve të caktuara nga Bashkia.

BËHET:

Ndalohet parkimi i varkave jashtë vendeve të caktuara nga Bashkia.

Gjoha: 500 lek

Gjoha: 1000 lek

Në pikën IV, "Për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike", neni 52

ISHTE:

Ndalohet tregtimi i pijeve alkoolike për moshat nën 16 vjeç, personave të dehur dhe të sëmurëve psikike.

BËHET:

Ndalohet tregtimi i pijeve alkoolike për moshat nën 16 vjeç, personave të dehur dhe të sëmurëve psikike.

Gjoha:
500-1000lek

Gjoha: 2000 lek

Në pikën IV, "Për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike", neni 53

ISHTE:

Ndalohet afishimi i shpalljeve, lajmërimeve, parullave, reklamave në mjedise të pamiratuara nga Bashkia.

BËHET:

Ndalohet afishimi i shpalljeve, lajmërimeve, parullave, reklamave në mjedise të pamiratuara nga Bashkia.

Gjoha:
500-1000lek

Gjoha: 2000 lek

Në pikën IV, "Për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike", neni 54

ISHTE:

Ndalohet tregtimi i pijeve alkoolike në mjedise ku ka veprimtari kulturore e sportive dhe vende publike si trotuare, parqe etj, jashtë ambienteve të caktuara për këtë qëllim.

BËHET:

Ndalohet tregtimi i pijeve alkoolike në mjedise ku ka veprimtari kulturore e sportive dhe vende publike si trotuare, parqe etj, jashtë ambienteve të caktuara për këtë qëllim.

Gjoha:
500-1000lek

Gjoha: 1000 lek

AKTIVITET

KORÇA PROMOVON PJESËMARRJEN AKTIVE

Ereandra Taiplari, CSDC, Korçë

Korça është tashmë një nga qytetet zbatuese të projektit **PROMOVIMI I ANGAZHIMIT QYTETAR TEK TË RINJTË NË SHQIPËRI**. Ky projekt zbatohet nga OSBE Prezenca në Shqipëri për një periudhë gjashtë mujore (Qershor-Nëntor) dhe përfshin qytetin e Durrësit dhe të Korçës.

Projekti u fokusua në promovimin e angazhimit qytetar nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në jetën komunitare

rinj punëkërkuës të papunë nga Panairi i Punës 2012.

Për realizimin e aktiviteteve, OSBE Prezenca në Shqipëri bashkëpunoi me gjashtë organizata lokale dhe institucionin e Bashkisë Korçë. Nga organizatat



përmendim:

Klinika KENEDI, Shoqata e Rehabilitimit Fizik, World Vision, Shoqata Gruaja në Zhvillim Korçë, Fondacioni HEC, dhe organizata kombëtare MEDPAK për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Këto organizata mirëpritën të rinjtë e projektit për t'i angazhuar ata në punë komunitare dhe vullnetare në ndihmë të grupeve të marxhinalizuara,

në kuadër të projekteve dhe programeve të tyre zbatuese.

Puna vullnetare e të rinjve u shtri në periudhën kohore 11 korrik- 30 gusht 2012. Të rinjtë u shprehen se pjesëmarrja e tyre në aktivitetet e projektit ishte

një eksperiencë pune dhe mësimore që u ka shërbyer për krijimin e marrëdhënieve dhe kontakteve të reja brenda dhe jashtë grupit;

për përfitimin e aftësive të reja; për njohjen me realitete të reja të qytetit. Kjo ka qenë pikërisht edhe qëllimi i zbatimit të projektit me të rinjtë. Të rinjve iu shpërnda edhe një certifikatë për angazhimin e tyre vullnetar në aktivitetet e projektit. Rezultat direkt i projektit ishte ideimi dhe organizimi i nismës vullnetare të grupit të të rinjve **“I DUA FËMIJËT , E DUA KORÇËN”** nga vetë të rinjtë. Kjo nismë përfshiu fushatën për ngritje fondesh në ndihmë



ku ata jetojnë. Projekti përfshiu aktivitete që synonin ngritjen e kapaciteteve të të rinjve në fushën e pjesëmarrjes aktive, realizimin e praktikave të angazhimit komunitar, shkëmbimin e eksperiencave, krijimin e partneriteteve me institucione dhe organizata lokale si dhe nxitjen e nismave rinore vullnetare.

Në këto aktivitete morën pjesë vullnetarisht 50 të rinj të qytetit të Korçës duke përfshirë studentë të Fakultetit të Shencave Shoqërore dhe Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Fan S. Noli”; nxënës të shkollës së mesme Raqi Qirinxhi dhe të Kolegjit “PREKA” si dhe të



të fëmijëve të Shtëpisë së Foshnjës dhe të fëmijëve të Qendrës “Shërbimet Sociale Bethani” si dhe ditën e hapur artistike me rastin e 24 tetorit, Çlirimit të Korçës dhe 100 vjetorit të Pavarësisë. Fondet u krijuan duke filluar nga një kuotë bazë e gjeneruara nga të rinjtë e fushatës dhe më pas nga kontributi vullnetar i qytetarëve të Korçës.

Këto fonde u mbikqyren dhe u administruan nga vetë grupi i të rinjve, duke pasqyruar aktivitete në mediat lokale. Këta të rinj u mbështetën me logjistikë nga CSDC Korça (Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile Korçë). Nisma të tilla vullnetare përbëjnë edhe vazhdimësinë e projektit në të ardhmen.

Ereandra Taiplari, CSDC, Korçë



Q U I T Z

Ky pyetësor synon të testojë informimin e qytetarëve për kompetencat, funksionet dhe rolin e Kryetarit të Bashkisë ose Komunës

Zgjidh alternativën e duhur, PO ose JO duke shënuar kuadratin

(Shkëputur nga Ligji Nr.8652, datë 31.7.2000 'PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE')

Neni 43

Simboli i kryetarit të komunës dhe bashkisë

Simboli dallues i kryetarit të komunës dhe bashkisë është ai i partisë nga radhët e së cilës është propozuar, me gjerësi 111 mm, i ndarë në tre sektorë me gjerësi të njëjtë, i kuq – i zi - i kuq.

PO JO

Simboli dallues vendoset krahëqafë, nga supi i djathtë në ijen e majtë, vetëm gjatë pritjeve zyrtare dhe mbledhjeve solemne.

PO JO

Kryetari mban detyrimisht këtë shirit në ceremonitë publike dhe në ceremonitë e lidhjes së martesave.

PO JO

Neni 44

Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të komunës ose të bashkisë

Kryetari i komunës ose bashkisë:

a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të komunës ose bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;

PO JO

b) është i detyruar të zbatojë aktet e këshillit të ministrave, por jo domosdoshmërisht ato të këshillit bashkiak ose komunal;

PO JO

c) merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin komunal ose bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;

PO JO

ç) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të paktën çdo 12 muaj.

PO JO

d) raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e qarkut;

PO JO

dh) është anëtar i komisionit të ligjeve;

PO JO

e) emëron dhe shkarkon zëvendës-kryetarin / zëvendëskryetarët e qarkut;

PO JO

ë) emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi të pushtetit qendror.

PO JO

f) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë jodrejtues të strukturave dhe njësive në varësi të komunës ose bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin

nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil";

PO JO

g) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar komunës ose bashkisë si person fizik;

PO JO

gj) teston çdo 12 muaj kualifikimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;

PO JO

h) kthen për rishqyrtim në këshill vendime, sa herë që vëren se ato çënojnë interesa të bashkësisë.

PO JO

Grupi Monitorues i Këshillit të Bashkisë Pogradec

1. Dorian Leka
2. Ligerta Karaj
3. Ledjan Zeqollari
4. Mariglen Vreto
5. Leonida Karaj
6. Marsela Çuli
7. Alda Isallari
8. Doralda Tanellari
9. Xhensila Topçiu
10. Alban Gusho
11. Besmira Isallari

TRAMPOLINA E VULLNETARIZMIT

vijon nga faqja 6

Pra, qartësisht vullnetarizmi është shumë i përhapur në botë, sepse koncepti i vullnetarizmit i injektuar tek brezat e rinj sot është: “Vullnetarizmi është veprimi i njerëzve të cilët investojnë në kohë, punë, njohuri dhe/ose punë për të mirën e të tjerëve dhe për dobinë e bashkësisë, pa prituri që të paguhet ose të kenë përfitim tjetër.

Ende vazhdoj të jem skeptike për vullnetarizmin në Shqipëri, sepse nuk ka një numër të saktë të atyre personave që bëjnë punë vullnetare pa prituri shpërblim. Por, ndoshta edhe për faktin se deri më sot Shteti Shqiptar nuk ka miratuar një ligj, sipas së cilit puna vullnetare të merret apo vlerësohet si eksperiencë e mirëqenë pune në CV, ndoshta për faktin se shumë pak e njohin dhe e vlerësojnë atë.

Megjithatë koncepti i vullnetarizmit të rinjtë është deri diku i njohur dhe i përhapur, ata kontribuojnë me mundësitë e tyre në punën vullnetare, këtu përfshirë edhe të rinjtë në qytetin e Pogradecit. Zhvillimet e ndryshme sociale, ekonomike apo edhe politike të përkrahura nga organizatat joqeveritare, nga shoqatat e ndryshme që aderojnë në gjithë vendin, si dhe me ndihmën e Shoqërisë Civile

deri diku, kanë shërbyer si një trampolinë në përkrahjen dhe zhvillimin e frymës së vullnetarizmit në formën e tij të re, si një punë që fal kënaqësi.

Shoqata “Unë, Gruaja” është një ndër shoqatat më të konsoliduara në rajon dhe jo vetëm ka influence pozitive, jo vetëm në luftën kundër dhunës në familje, por edhe sepse ka shumë vite që përkrah dhe mbështet iniciativat e të rinjve. Edhe pse është një shoqatë që ofron mbështetje dhe këshillim për gratë dhe vajzat e dhunuara ajo jep mundësi të shumta në rikuperimin e kohës së humbur nga ato. Një numër i konsiderueshëm të rinjsh kanë frekuentuar dyert e shoqatës dhe janë bërë për vite me rradhë kontribues të fushatave kundër dhunës dhe jo vetëm, vepse veprimtaria e saj është e përhapur në shumë sfera të jetës shoqërore dhe ekonomike në qytetin e Pogradecit. Do thoja që vullnetarizmi është një ndenjë që mësohet të rritet dhe zhvillohet tek këta të rinj, nga stafi i kësaj shoqate, e cila përkrah të gjithë ata të rinj që janë pjesë e grupit të vullnetarëve dhe jo vetëm.

Eksperiencia e fituar nga puna e bërë pranë shoqatës i bën të rinjtë të mos mendojnë me egoizëm rreth përfitimit monetar, por për kënaqësinë që ata marrin duke kontribuar dhe më pas duke parë frytet e punës së tyre vulosur

mbi një ekperience pozitive pune dhe jete.

Shoqata “Unë, Gruaja” në kuadër të nismës: “Angazhohu- Monitoro-Vepro” lidhur me Monitorimin e Këshillit Bashkiak - Pogradec, ka mbledhur një grup me të rinjsh vullnetarë të arsimuar dhe vizionarë. Vullnetarët e këtij grupi ndjekin me kërkësi dhe me ndjenjë kritikës pozitive mbledhjet e Këshillit Bashkiak, Pogradec. Janë ata që mbajnë shënime, bëjnë intervista, analizojnë situata paralele dhe në disa raste, janë ata që japin mendime dhe sugjerime lidhur me situata të caktuara. Të gjitha impresionet e marra hidhen në letër për t’u botuar më pas në buletin e përmuajshëm në gazetën “Nositi”. Kjo është një mundësi pozitive për këta të rinj, të cilët gjithmonë edhe më tepër bëhen pjesë aktive në shoqëri, duke mësuar, punuar dhe së fundmi eksploruar në lëmin e mundësive që shoqata “Unë, Gruaja” ofron për ta.

Ndryshimet në mënyrën e konceptimit të vullnetarizmit kanë shërbyer si një trampoline për t’u hedhur nga padija drejt dijes, nga nevoja në dëshirë, nga dëshira pozitive në vullnetarizëm. Atëherë kur të rinjtë do shpenzojnë më pak kohë në kafene dhe më tepër në punë vullnetare, atëherë do të shihen frytet e një vendi të emancipuar dhe europian.

Doralda Tanellari, grupi monitorues



“Publikimi i këtij materiali mbështetet financiarisht nga Zyra e Çështjeve Publike e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit Amerikan të Shtetit”